Numër: 02-687 Datë: 14.07.2026

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1, 2 dhe nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, duke vendosur sipas kërkesës së protokolluar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) me nr. 02/166, datë 26.03.2024, nenit 23 paragrafi 2 dhe 3, të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në ndërlidhje me nenin 11 paragrafi 3 të Ligji Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, u.d. i Drejtorit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë: 14.07.2026. merr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet kërkesa nr. 02-682, e datës 09.07.2026 për Qasje në Dokumente Publike e parashtruar nga Instituti ATC.

2. Vendimit i bashkëngjiten dokumentet e kërkuara:
   2.1. Procesverbali i mbledhjes së KD-AKK;
   2.2. Raporti i validimit per kualifikimin Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit si dhe raportin e akreditimit të Institucionit ATC.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Me datë: 09.07.2026 Z. Pleurat Stublla, bazuar në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka parashtruar në AKK kërkesë për Qasje në Dokumente Publike e cila është e protokolluar dhe ka marrë nr. 02-682. Përmes kësaj kërkese z. Stublla ka kërkuar nga AKK qasje në Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Drejtues të Autoritet Kombëtar të Kualifikimeve si dhe Raportin e validimit për kualifikimin: ''Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit'' dhe raportin e akreditimit të Institutit ''ATC'' i cili i është paraqitur Këshillit Drejtues lidhur me kërkesën për riakreditim dhe rivalidim të Institutit Profesional ATC. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve brenda afatit ligjor të paraparë me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike shqyrtoj kërkesën e z. Stublla dhe mori vendim që kërkesa të APROVOHET.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa në organin kompetene që shqyrton ankesat për qasje në dokumente publike sipas* Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Z. Naim Gashi

U.d. i Drejtorit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

Vendimi u dërgohet:

- Institutit ''ATC''
- Arkivit të AKK.